

Messer Albagaz Sh.p.k.
Pasqyrat Financiare Paraprake SNRF
Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(me raportin e audituesve të pavarur bashkëlidhur)

Përmbajtja

	Faqja
RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR	
Pasqyrat Financiare Paraprake SNRF:	
Pasqyra paraprake e pozicionit financiar	1
Pasqyra paraprake e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse	2
Pasqyra paraprake e ndryshimeve ne kapital	3
Pasqyra paraprake e flukseve monetare	4
Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare paraprake SNRF	5 – 21



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Aksionarit të
Messer Albagaz sh.p.k

Tiranë, 31 mars 2014

Ne kemi audituar pasqyrat financiare paraprake SNRF të Messer Albagaz Sh.p.k ("Shoqëria") të cilat përbëhen nga pasqyra paraprake e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013, pasqyrat paraprake të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme dhe informacione të tjera shpjeguese ("pasqyrat financiare paraprake SNRF"). Pasqyrat financiare paraprake SNRF janë përgatitur nga drejtimi në kuadër të transferimit të Shoqërisë në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare Paraprake SNRF

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare paraprake SNRF në përputhje me bazat e përcaktuara në shënimin 2.a) të pasqyrave financiare paraprake SNRF, i cili përshkruan se si SNRF janë zbatuar sipas SNRF 1, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare paraprake SNRF bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare paraprake SNRF. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare paraprake SNRF, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare paraprake SNRF në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatesë të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare paraprake SNRF.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.


Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraprake SNRF të Messer Albagaz Sh.p.k për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013, janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me bazat e përcaktuara në shënimin 2.a) të pasqyrave financiare paraprake SNRF, i cili përshkruan si SNRF janë zbatuar sipas SNRF 1, duke përfshirë supozimet e bëra nga drejtimi në lidhje me standardet dhe interpretimet e tyre që pritet të jenë efektive, si dhe me politikat që pritet të adoptohen kur drejtimi të përgatisë pasqyrat a para të plota financiare sipas SNRF për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014.

Baza e Kontabilitetit

Pa e kualifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen për shënimin 2.a) të pasqyrave financiare paraprake SNRF, që shpjegon se ka një mundësi që këto pasqyra financiare paraprake SNRF mund të kenë nevojë për rregullime përpara përfshirjes në pasqyrat e plota financiare SNRF për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014. Gjithashtu, siç përmendet në Shenimin 21 të pasqyrave financiare paraprake SNRF si pjesë e transferimit në SNRF, Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra financiare paraprake SNRF për të përcaktuar pozicionin financiar, rezultatet e veprimtarive dhe flukset e mjeteve monetare të Shoqërisë, si të nevojshme për të siguruar informacionin financiar krahasues që pritet të përfshihet në paketën e parë të plotë të pasqyrave financiare SNRF për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014. Pasqyrat financiare paraprake SNRF nuk përfshijnë informacion financiar krahasues për periudhën e mëparshme.

Steven Nutley
Partner



KPMG Albania Sh.p.k.
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana,
Albania

Messer Albagaz Sh.p.k.

Pasqyra paraprake e pozicionit financiar


Shumat ne Lek '000

	Shënime	31 dhjetor 2013	1 janar 2013
Aktivet			
Aktive afatgjata të trupëzuara	5	459,136	458,512
Tatim i shtyrë	16	-	501
Aktive afatgjata		459,136	459,013
Inventari	6	20,394	32,205
Të arketueshme tregtare dhe të tjera	7	46,111	44,229
Tatim fitimi i parapaguar		2,228	1,603
Parapagime dhe aktive të tjera	8	1,157	1,111
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	9	27,189	23,810
Aktive afatshkurtra		97,079	102,958
Totali i aktiveve		556,215	561,971
Kapitali			
Kapitali aksionar	10	511,772	511,772
Rezerva	10	6,208	6,208
Humbje të mbartura		(150,549)	(74,528)
Totali i kapitalit		367,431	443,452
Detyrimet			
Detyrimet e shtyra tatimore	16	3,270	-
Detyrimet afatgjata		3,270	-
Detyrime tregtare dhe të tjera	11	163,544	105,165
Parapagimet	12	21,970	13,354
Detyrimet afatshkurtra		185,514	118,519
Totali i detyrimeve		188,784	118,519
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		556,215	561,971

Pasqyra paraprake e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare paraprake SNRF në faqet 5 deri 21.

Keto pasqyra paraprake SNRF janë miratuar nga aksioneri kryesor i Shoqërisë më 20 Mars 2014 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:


Ardian Strazimiri
Drejtori Manaxhimi



Dimitar Popchev
Drejtor Manaxhimi



Mirvjena Shehu
Kryetare Deges Finances



Messer Albagaz Sh.p.k.

Pasqyra paraprake e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Shumat ne Lek '000

	Shënime	2013
Shitje	13	268,268
Kosto e shitjes	13	(248,146)
Ftimi bruto		20,122
Të ardhura të tjera		1,273
Shpenzime të shitjes dhe shpërndarjes	14	(74,516)
Shpenzime administrative	15	(17,836)
Rezultati nga veprimtaria operative		(70,957)
Shpenzime financiare		(516)
Humbja para tatimit		(71,473)
Shpenzimet tatimore	16	(4,548)
Humbja e vitit		(76,021)
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatim fitimi		-
Totali i humbjes përmbledhëse të vitit		(76,021)

Pasqyra paraprake e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare paraprake SNRF në faqet 5 deri 21.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Pasqyra paraprake e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Shumat ne Lek '000

	Kapitali aksionar	Rezerva	Humbje të mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2013	511,772	6,208	(74,528)	443,452
Veprimet me pronarët të regjistruara direkt në kapital				
Kontribute nga aksionarët	-	-	-	-
Totali i kontributeve nga aksionarët	-	-	-	-
<i>Totali i humbjes përmbledhëse për vitin</i>				
Humbja e vitit	-	-	(76,021)	(76,021)
Humbje te tjera përmbledhëse, neto pas tatim fitimit	-	-	-	-
Totali i humbjes përmbledhëse të vitit	-	-	(76,021)	(76,021)
Gjendja më 31 dhjetor 2013	511,772	6,208	(150,549)	367,431

Pasqyra paraprake e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare paraprake SNRF te paraqitura në faqet 5 deri në 21.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Pasqyra paraprake e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Shumat ne Lek '000

	Shënime	2013
Flukse monetare nga veprimtari operative:		
Humbje e periudhes përpara tatimit		(71,473)
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësim	5	18,992
		<u>(52,481)</u>
<i>Ndryshime ne aktiveve dhe detyrime:</i>		
Ndryshimi në inventar		11,811
Ndryshimet në llogaritë e arkëtueshme		(1,882)
Ndryshimet në aktivet e tjera		(46)
Ndryshimi në furnitorë dhe te tjere		58,379
Ndryshimet ne detyrimet e tjera		8,616
Tatimi i paguar		(1,402)
Mjete monetare neto përdorur në veprimtarite operative		<u>22,995</u>
Fluksi monetar nga veprimtari investuese		
Blerje e aktiveve afatgjata të trupëzuara		(19,616)
Fluksi neto për veprimtari investuese		<u>(19,616)</u>
Rritja neto ne mjete monetare		<u>3,379</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit		<u>23,810</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor	9	<u><u>27,189</u></u>

Pasqyra paraprake e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare paraprake SNRF të paraqitura në faqet 5 deri në 21.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. Hyrja

a) Informacion i përgjithshëm

Messer Albagaz Sh.p.k. ("Shoqëria") është një shoqëri që ushtron veprimtarinë e saj në Tiranë. Shoqëria është e përfshirë në prodhimin, shitjen, dhe shpërndarjen e gazrave teknike, mjekësore dhe të vecanta, si dhe shitjen e pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit në lidhje me biznesin kryesor. Shoqëria është regjistruar në vitin 2007 dhe në 2011 u ble nga Messer Tehnogas, një Shoqëri me bazë në Serbi. Messer Tehnogas është pronari i vetëm i Shoqërisë.

Më 31 dhjetor 2013, Shoqëria operonte nga depot e saj në Tiranë dhe Gjirokastrë.

b) Vlerësimi i manaxhimit mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijëmsisë

Shoqëria ka humbje të akumuluar prej 150,549 mijë Lek (2012: 74,528 mijë Lek) deri më 31 dhjetor 2013. Kjo është kryesisht për shkak të fazës së nisjes, që pasoi ndryshimin e pronësisë më 2011 dhe për shkak të konkurrencës vendase. Shoqëria mbështetet nga kontributet e pronarit. Përveç kësaj, në mënyrë që të plotësojë nevojat e kapitalit dhe të vazhdojë operacionet, Shoqëria ka huazuar fonde nga palët e lidhura.

Drejtimi beson se Shoqëria do të jetë në gjendje të gjenerojë fitime në të ardhmen dhe aftësia e saj për të vazhduar sipas parimit të vijëmsisë nuk do të dobësohet. Për këtë arsye Shoqëria i ka përgatitur këto pasqyra financiare në bazë të parimit të vijëmsisë.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Si pjesë e tranzicionit të saj në SNRF, Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra financiare paraprahe SNRF për të përcaktuar pozicionin financiar, rezultatet e veprimtarive dhe flukset e mjeteve monetare të Shoqërisë, të nevojshme për të siguruar të dhënat financiare krahasuese, të cilat priten të përfshihen në pasqyrat e para financiare SNRF të plota të Shoqërisë më 31 dhjetor 2014.

Pasqyrat financiare paraprahe SNRF përgatitur në bazë të SNRF 1, nuk përfshijnë informacion krahasues financiar të plotë për periudhën e mëparshme SNRF, përfshirë edhe supozimet manaxheriale në lidhje me standardet dhe interpretimet që priten të jenë efektive, dhe politikat që priten të miratohen, kur menaxhimi të përgatisë paketën e parë të plotë të pasqyrave financiare SNRF më 31 dhjetor 2014.

Ka një mundësi që pasqyrat financiare të SNRF paraprahe mund të kërkojnë rregullime para se të përbëjnë pasqyrat financiare përfundimtare SNRF më 31 dhjetor 2014, kur Shoqëria të përgatisë paketën e parë të plotë të pasqyrave financiare SNRF. Në shënimin 21 është sqaruar sesi tranzicioni në SNRF ka ndikuar në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të Shoqërisë.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Gjithë informacioni financiar paraqitet në Lek i rumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur tregohet se është paraqitur ndryshe.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në vecanti, informacionet mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet kritike në aplikimin e SNRF, që kanë efekt të kosniderueshëm në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimin 4. Gjithashtu, gjykimet dhe vlerësimet e bëra në lidhje me detyrimet e mundshme paraqiten në shënimin 18 dhe gjykimet mbi zhvlerësimin e kërkesave të arkëtueshme paraqiten në shënimin 17 (b).

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Aktivet dhe detyrimet financiare

i. Aktivet financiare jo- derivative

Shoqëria fillimisht njih llogarite e arkëtueshme tregtare e të tjera dhe depozitat në datën që ato kane ndodhur. Te gjitha aktivet e tjera financiare njihen fillimisht ne datën e tregtimit, datë në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron nje aktiv financiar kur te drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose ai i transferon të drejtat e marrjes së flukseve monetare kontraktuale mbi aktivin financiar nepermjet nje transaksioni ku transferohen në menyreë thelbesore të gjitha Rreziqet dhe perfitimet e zoterimit te aktivit financiar. Cdo interes ne aktivet financiare te transferuara qe është krijuar apo mbajtur nga Shoqëria, njihet si nje aktiv apo detyrim më vete.

Aktivt dhe detyrimet financiare netohen së bashku dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejte ligjore për te paraqitur shumat neto dhe ka për qellim ose për të mbyllur veprimin me to mbi nje baze vlere neto, ose për të realizuar shitjen e aktivit dhe blerjen e detyrimit në të njëjtën kohë.

ii. Llogaritjet e arketueshme tregtare dhe të tjerat

Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera jane aktive financiare me pagesa fikse ose te percaktuara qe nuk jane regjistruar ne nje treg aktiv. Aktive te tilla njihen fillimisht me vleren e drejte te tregut, plus cdo kosto transaksioni qe lidhet drejtperdrejte me to. Pas njohjes fillestare llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera maten me metoden e koston se amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, minus cdo renie te vleres.

iii. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe të ngjashmet me to përbëhen nga tepricat e parave te gatshme dhe depozitave pa afat, ose me maturimin fillestar prej tre muaj ose më pak. Mjetet monetare janë perfshire me kosto të amortizuar në pasqyra.

iv. Detyrime financiare jo-derivative

Shoqëria fillimisht njih detyrimet financiare në datën e tregtimit, datë në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen apo humbin vlefshmërinë e tyre.

Aktivt dhe detyrimet financiare netohen së bashku dhe shuma neto paraqitet ne pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të paraqitur të mbledhura bashkë shumat dhe ka për qëllim ose për të mbyllur veprimin me to mbi nje bazë vlerë neto, ose për të realizuar shitjen e aktivit dhe blerjen e detyrimit në të njëjtën kohë.

Shoqëria ka keto detyrimeve financiare jo derivative: tregtare dhe pagesa te tjera dhe detyrime te tjera.

Detyrime te tilla financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, plus cdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërdrejt më të. Pas njohjes fillestare keto detyrime financiare maten me metodën e koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(b) Inventari

Inventarët maten me vleren më të ulët mes koston dhe te vlerës neto të realizueshme.

Kosto e inventarit bazohet në metodën 'FIFO' dhe perfshin koston e ndodhura gjatë blerjes së inventarëve, prodhimit ose shnderrimit, kosto të tjera të kryera për levizjen e tyre në vendin dhe gjendjen e gatshme për perdorim.

Vlera neto e realizueshme eshte cmimi i vleresuar i shitjes gjate rrjedhës së zakonshme te biznesit minus cdo kosto të vlerësuar perfundimin dhe shpenzimet e shitjes.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

(c) Aktivet afatgjata të trupëzuara

- *Njohja dhe matja*

Aktivitet afatgjata të trupëzuara maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rena në vlerë.

Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, cdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me përgatitjen e aktiveve në gjendje pune për qëllimin e përdorimit të tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementëve dhe rikthimit të tokës në gjendjen origjinale. Programet (software) e blerë të cilët janë pjesë tërësore në funksionalitetin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohen si pjesë e kësaj pajisje.

Kur pjesë të një objekti të aktiveve afatgjata të trupëzuara kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si objekte të vecanta (përbërës kryesorë) të aktiveve afatgjata të trupëzuara.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një objekti të aktiveve afatgjata të trupëzuara përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën e mbartur të ndertesës dhe pajisjeve, dhe janë të njohura si të ardhura neto në kategorinë e të ardhurave të tjera, në fitim ose humbje.

- *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata të trupëzuara i shtohet vlerës së mbetur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që lidhen me këtë element do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me saktësi. Kostot e mirëmbajtjeve ditore të aktiveve afatgjata të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

- *Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e llogaritjes mbi vlerën e mbetur dhe normat e zhvlerësimit janë si më poshtë:

- | | |
|------------------------|---------|
| • Ndërtesa | 5% |
| • Makineri dhe pajisje | 7%- 20% |
| • Bombula | 5% |

Toka nuk zhvlerësohet.

(d) Transaksionet në monedhe të huaj

Transaksionet në monedhe të huaj konvertohen në monedhen funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare të regjistruara në monedha të huaja në datën e raportimit konvertohen në monedhen funksionale me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhen funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhe të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të regjistruara në monedhe të huaj që maten me kosto të amortizuara, konvertohen në monedhe funksionale me kursin e këmbimit në datën kur kryhet transaksioni. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të regjistruara në monedhe të huaj që maten me vlerë të drejte të tregut konvertohen në monedhe funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejte e tregut.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

(e) Zhvlerësimi

i Aktivet financiare

Nje aktiv financiar, i cili nuk regjistrohet me vleren e drejte të tregut përmes pasqyres së të ardhurave, vlerësohet në fund të cdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që tregon se mund të jetë i zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidence objektive zhvlerësimi tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar dhe kjo mund të vlerësohet në menyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë pamundesi apo veshtiresi të një klienti për të realizuar pagesën, ristrukturim të një detyrimi ndaj Shoqëriat me kushte që Shoqëria nuk do të hynte në raste të tjera, ose treguese që nje klient do të shpallë falimentim.

Shoqëria konsideron evidence të zhvlerësimit të llogarisë së kërkesave të arketueshme, si në nivel specifik të aktivitetit ashtu edhe ne grup. Të gjithë klientet specifike vlerësohen për zhvlerësim specifik. Te gjithë klientët specifike të rëndësishëm, të cilët nuk janë vlerësuar si të zhvlerësuar specifikisht, janë vlerësuar në grup për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur, por nuk është identifikuar ende. Klientët që nuk janë shumë të rëndësishëm specifikisht janë vlerësuar në grupe bazuar në tipare te ngjashme rreziku.

Gjate vlerësimit ne grup, Shoqëria përdor të dhenat historike të probabilitetit të mospageses, kohën e mbledhjes dhe shumen e humbjes së ndodhur, të rregulluar sipas gjykimeve te drejtimit nëse kushtet e tanishme ekonomike dhe të kreditimit janë të tilla që humbjet aktuale të kenë mundesi të jenë më të mëdha apo më të vogla sesa të vlerësuar nga të dhënat historike.

Humbja nga zhvlerësimi i nje aktiviteti financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe paraqiten si llogari provizioni kundrejt llogarive të arkëtueshme. Një humbje nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi apo pakesimi i zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje.

ii Aktivet jofinanciare

Vlerat e mbartura të aktiveve jo-financiare të Shoqërise, përveç inventareve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen në cdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse ka evidence të tillë, atëherë vlera e rikuperueshme e aktivitetit vlerësohet. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose njesie gjeneruese te mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës së tij në perdorim dhe vlerës së tij te drejtë minus kostot per t'u shitur. Në vlerësimin e vlerës në perdorim, flukset e ardhshme monetare skontohehen për të dhënë vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe Rreziqet specifike të aktivitetit. Me qëllim testimin për zhvlerësim, aktivet që nuk mund të testohen në menyrë individuale grupohen së bashku në njesine më të vogël të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga perdorimi i vijueshem që janë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera apo grupeve të tjera të aktiveve ("njësi gjeneruese e mjeteve monetare ose NJGJMM").

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktiviteti ose NJGJMM e tejkalon shumën e rikuperueshme të vlerësuar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me NJGJMM shpërndahen për të zvogëluar vlerën e mbartur të aktivitetit në njësi (grup njësisish) në varësi të peshës së secilit.

Humbja nga zhvlerësimi rishikohet në cdo datë raportimi për tregues qe humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi kthehet nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetem në masën, në të cilën vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbetur të tij që percaktohet nga vlera neto e tij pas amortizimit, nëse nuk ka humbje nga zhvlerësimi.

(f) Provigjionet

Një provigjion njihet kur Shoqëria , si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose strukturor, që mund të matet në menyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohej nje fluks dalës të mirash ekonomike për të shlyer detyrimin. Provigjionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare më një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vleren në kohë të parasë dhe Rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi kohor i skontimit njihet si kosto financiare.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Të ardhurat

Të ardhurat nga shitja e mallrave në rrjedhën e aktiviteteve të zakonshme matet me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, neto e kthimit, ulje të tregtisë dhe vëllimit. Të ardhurat njihen kur ekzistojnë prova bindëse, zakonisht në formë të mallrave të konfirmuara dhe të dorëzuara, se rreziqet e mëdha dhe përfitimet e pronësisë i janë transferuar blerësit, shërimin e shumës është e mundshme, kostot e shoqëruara dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të jetë vlerësohet në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirja e vazhdueshme të menaxhimit me mallrat, dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Nëse është e mundur që do të jepet ulje dhe shuma mund të matet me besueshmëri, atëherë zbritja njihet si reduktim i të ardhurave nga shitja kur ato njihen.

Koha e transferimit të risqeve dhe perfitimeve varet nga kushtet specifike të procesit të shitjes.

(h) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

(i) Përfitimet e punonjësve

- *Planet e kontributeve të percaktuara*

Shoqëria merr pjesë në kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore që japin përfitimet e pensionit për punonjëit e saj pas daljes në pension. Detyrimeve për kontribute të tilla për të percaktuar planet e pensioneve njihen si shpenzime në fitim ose humbje, kur ka detyrim. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për sigurimin dhe përcaktojnë pragun ligjor minimal për pensionet në kuadrin e një plani pensionesh të percaktuar.

- *Pagesat për lejet vjetore*

Shoqëria njihet si detyrim shumen e pazbritur për shpenzimet e vlerësuara e të lidhura me pushimet vjetore që priten të paguhet në kembim të shërbimit të punonjesit për periudhën e perfunduar.

- *Përfitime afatshkurtër*

Detyrimet afatshkurtra që punonjësit përfitojnë, maten në një bazë të paskontuar njihen si shpenzime në momentin e kryerjes së shërbimit.

(j) Tatimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës njihet në fitim/ humbje, përveç pjesës që lidhet me elementët që njihen direkt në llogarinë e kapitalit ose në të tjera të ardhura përmbledhëse.

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar nga të ardhurat e tatueshme ose humbja për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose të miratuar në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar. Në percaktimin e vlerës së tatimit fitimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr parasysh impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse taksat dhe interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Shoqëria beson se përlllogaritjet për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet, bazuar në vlerësimin e shume faktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në llogaritje dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacion i ri mund të jetë në dispozicion dhe mund të shkaktojë që Shoqëria të ndryshojë gjykimet në lidhje me përshtatshmerinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të kenë impakt mbi tatim fitimin në periudhat që ky percaktim bëhet.

Aktivitetet për tatime të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura, kreditë e taksave dhe diferencat e përkohshme të zbritshme, në atë masë që është e mundur që do të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktiviteti tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal. Aktivitetet dhe detyrimet e shtyra tatimore paraqiten neto në qoftë se ka një të drejtë të kërkueshme me ligj për të netuar aktivitetet dhe detyrimet aktuale tatimore, dhe ato lidhen me tatime mbi të ardhurat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor, për të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivitetet aktuale tatimore në bazë neto, ose aktivitetet dhe detyrimet tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Standarde dhe interpretime të reja që nuk janë adoptuar ende

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime, nuk ishin ende efektive për vitin që u mbyll më 31 dhjetor 2013, dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga keto standarde nuk pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

4. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

Disa nga politikat kontabël të Shoqërisë dhe notave shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe/ose prezantimi bazuar në metodat në vijim. Ku është e aplikueshme informacioni mëtejshëm rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë është prezantuar në notat shpjeguese specifike të aktiveve dhe detyrimeve. Përveç kësaj, gjykimet e përfshira në njohjen e aktiveve tatimore të shtyra janë përkrahur në shënimin 16.

Provigjionimet

Për të përcaktuar nëse një provigjon duhet të regjistrohet, Shoqëria bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregon se ka ndonjë rrezik të identifikuar dhe të matshëm në flukset monetare të ardhshme që lidhen me tatimet dhe gjokat për shembull. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim në kushtet ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me humbje të mundshme. Menaxhimi përdor vlerësimet bazuar në humbje të shkuara dhe prova objektive të zhvillimeve aktuale të ngjashme kur bën vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si sasinë edhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar diferencat midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës me humbjet.

Llogari të arketueshme tregtare dhe të tjera

Vlera e drejtë e tregut për llogaritë e arketueshme tregtare dhe të tjera, vlerësohen si vlera aktuale e flukseve monetare të ardhme, skontuar duke përdorur normën e interesit të tregut në datën e raportimit. Kjo vlerë e drejtë e tregut përcaktohet për qëllime informimi dhe konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën e mbartur. Në shënimin 17 (b) sqarohet se cilat janë politikat e zhvlerësimit dhe cregjistrimit të huave.

Aktivitet monetare dhe të ngjashme

Aktivitet monetare dhe të ngjashme përfshijnë parate në arke dhe llogaritë rrjedhese me bankat rezidente. Meqenëse keto teprica janë afatshkurter, vlera e tyre e drejtë e tregut është konsideruar të jetë e barabartë me vlerën e mbartur.

Detyrimet financiare jo-derivative

Vlera e drejtë, e cila është përcaktuar për qëllime të informimit, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të principalit dhe të interesit flukseve monetare të ardhshme, të skontuar me normën e tregut të interesit në datën e raportimit.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

5. Aktive afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Bombula	Totali
Kosto					
Më 1 janar 2013	184,334	116,165	139,565	60,037	500,101
Shtesa	-	239	12,166	12,351	24,756
Shitje dhe pakësim	-	-	(3,943)	(3,783)	(7,726)
Më 31 dhjetor 2013	184,334	116,404	147,788	68,605	517,131
Zhvlerësim i akumuluar					
Më 1 janar 2013	-	(10,858)	(25,138)	(5,593)	(41,589)
Shpenzime për vitin	-	(4,819)	(11,082)	(3,091)	(18,992)
Shitje dhe pakësim	-	-	1,291	1,295	2,586
Më 31 dhjetor 2013	-	(15,677)	(34,929)	(7,389)	(57,995)
Vlera e mbartur					
Më 1 janar 2013	184,334	105,307	114,427	54,444	458,512
Më 31 dhjetor 2013	184,334	100,727	112,859	61,216	459,136

Shpenzimet e zhvlerësimit janë shpërndarë si më poshtë:

	2013
Kosto e shitjeve	9,348
Shitje dhe shpërndarje	8,635
Shpenzimet administrative	1,009
Totali	18,992

6. Inventari

	2013
Mallrat	12,454
Materiale të para	6,431
Furnizime operative	1,509
Totali	20,394

7. Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

	2013
Te arkëtueshme nga palët e lidhura	24,490
Të arkëtueshme nga palët e treta	83,346
Fond zhvlerësimi i kërkesave të arkëtueshme	(61,725)
Totali	46,111

Lëvizja në fondin e zhvlerësimit të kërkesave të arkëtueshme paraqitet si më poshtë:

	2013
Teprica e zhvlerësimit më 1 Januar	26,656
Shpenzimi neto i vitit	35,069
Më 31 dhjetor	61,725

8. Parapagime edhe aktive të tjera

	2013
Parapagime	150
Parapagime tatimore (TVSH)	754
Aktive të tjera afat shkurtër	253
Totali	1,157

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprake SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

9. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	2013
Para ne arke	480
Para ne banka	26,709
	27,189

10. Kapital

Më 31 dhjetor 2013, kapitali themeltar i regjistruar prej 505,272,000 Lek përbehej nga 100 aksione, secila prej tyre me një vlerë nominale prej 5,052,720 Lek për aksion. Pronari i vetem i Shoqërisë është Messer Tehnogas dhe kapitali themeltar më 31 dhjetor ka qenë si më poshtë:

	2013
Kapital i regjistruar	505,272
Kapital i paregjistruar	6,500
	511,772

Rezervat prej 6,208 mijë Lek paraqesin rezerva të krijuara me vendim të pronarit në datën 24 shkurt 2012.

11. Detyrime tregtare dhe të tjera

	2013
Llogaritë e pagueshme tregtare	29,512
Detyrime ndaj palëve të lidhura	130,267
Bonus i përlllogaritur i manaxhimit	2,344
Detyrime ndaj personelit	680
Tatim i pagushëm	80
Shpenzimet e përlllogaritura	661
	163,544

12. Parapagime

	2013
Parapagime	21,970
	21,970

Parapagimet përfaqësojnë garanci të vendosura nga konsumatorët për marrjen në dorëzim të bombulave të gazit.

13. Fitimi bruto

	2013
Shitje palëve të treta	256,380
Shitje palëve të lidhura	11,888
Shitje	268,268
Kosto e shitjeve me shumicë	(124,393)
Kosto e shitjeve me bombula	(123,753)
Kosto e shitjeve	(248,146)
Fitimi bruto	20,122

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprake SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

14. Shpenzime të shitjes dhe shpërndarjes

	2013
Shitje	56,547
Shpërndarje	9,746
Paketim	8,223
	74,516

Shpenzimet e shitjes përfshijnë fondin e zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme për vitin, prej 35,069 mijë Lek (shiko shënimin 7). Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë:

	2013
Paga dhe shpërblime	27,725
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	2,747
Të tjera	248
Totali	30,720

Më 31 dhjetor 2013, Shoqëria punësonte 21 punonjës. Shpenzimet e personelit janë ndarë sipas funksionit si më poshtë:

	2013
Kosto e shitjeve	12,414
Shpenzime të shitjes dhe shpërndarjes	12,060
Shpenzime administrative	6,246
Totali	30,720

15. Shpenzime administrative

	2013
Kosto personeli	6,246
Udhëtim dhe transport	3,488
Shitje aktivesh	1,795
Qira	1,205
Mirëmbajtje dhe riparime	1,161
Përfaqesime e dhurime	1,115
Zhvlerësim aktivesh	1,009
Ligjore dhe konsulenca	373
Shërbime sigurie	227
Telefon e komunikim	258
Taksa dhe detyrime doganore	182
Sigurime	194
Shpenzime të tjera zyre	114
Gjoha	469
	17,836

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprake SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

16. Shpenzime tatimore

	2013
Tatim i vitit	777
Tatim i shtyrë	3,771
Totali	4,548

Shoqëria përcakton taksën në fund të vitit në lidhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Në vitin 2013, norma e tatimit ishte 10% e fitimit të tatueshem. Taksa e shtyrë është llogaritur, duke u bazuar në normën e miratuar tatimore prej 10% deri më 31 dhjetor 2013, dhe me 15% nga viti 2014 dhe në vazhdim. Më poshtë është një barazim i tatimit, llogaritur me normën përkatëse me shpenzimin e tatimit:

	Norma e tatimit	2013
Humbje para taksave		(71,473)
Llogaritja me normen 10%	(10%)	(7,147)
Shpenzime të panjohura për qëllime tatimore	(14%)	10,195
Efekti i ndryshimve në normën e tatimit	(2%)	1,505
Kthimi i taksave të shtyra të njohura më parë	(3%)	2,266
Përdorimi i humbjeve të mbartura të panjohura më parë	3%	(2,271)
	6%	4,548

Humbjet fiskale paraqesin humbjet e tatueshme të Shoqërisë të mbartura nga e shkuara në periudhat e ardhshme. Periudha e mbartjes së humbjeve fiskale sipas ligjit në Shqipëri është tre vjet. Humbjet e akumuluarat tatimore më 31 dhjetor 2013, përpara zbatimit të normës tatimore janë detajuar më poshtë:

Humbjet tatimore të mbartura:	Humbjet tatimore	Përdorimi	Neto
Viti 2011	5,455	(5,455)	-
Viti 2012	52,266	(17,255)	35,011
Më 31 dhjetor 2013	57,721	(22,710)	35,011

Shoqëria nuk ka njohur aktive tatimore të shtyra në lidhje me humbjet tatimore, për faktin se nuk është e sigurt nëse aktivet tatimore të shtyra do të shfrytëzohen. Lëvizjet mbi aktivet/detyrimet tatimore të shtyrataksat janë si më poshtë:

	1 janar 2013	Lëvizjet	31 dhjetor 2013
Aktive afatgjata materiale	(2,165)	(1,105)	(3,270)
Zhvlerësimi i të arkëtueshmeve	2,666	(2,666)	-
Aktivet/(detyrimet) e shtyra	501	(3,771)	(3,270)

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

17. Administrimi i rrezikut financiar

(a) Hyrje dhe pamje e përgjithshme

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve nga përdorimi i instrumentave të saj financiare:

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut
- Rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit.

Administrimi i Rrezikut

Bordi Drejtues mban përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin dhe mbikqyrjen e politikave të Shoqërisë për manaxhimin e rrezikut.

Politikat e manaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Shoqëria, përmes standardeve dhe procedurave të manaxhimit synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Zhvillimet e vitit

Shoqëria operon në gjendjen e një krize globale financiare dhe ekonomike, zhvilluar në mënyre dinamike. Zgjerimi i saj i mëtejshëm mund të rezultojë në pasoja negative në gjendjen financiare të Shoqërisë. Drejtimi i Shoqërisë kryen monitorimin e përditshëm për të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurat dhe shpenzimet, duke zbatuar praktikën më të mira. Drejtimi i bazuar në këto analiza për përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve zbaton masat në lidhje me Rreziqet e kredisë, tregut dhe likuiditetit, duke kufizuar efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Shoqëria i përgjigjet sfidave të mjedisit të tregut, duke ruajtur një pozitë të qëndrueshme të kapitalit dhe të likuiditetit.

Faza e fillimit të veprimtarisë së Shoqërisë, që është arsyeja kryesore për humbjet, është mbështetur nga kontributet e pronarit.

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktual që lind kryesisht nga llogaritë e arketueshme të Shoqërisë. Për qëllime të raportimit të drejtimit të rrezikut, Shoqëria konsideron këto elemente të ekspozimit të rrezikut të kredisë (të tilla si rreziku i humbjes së aftësisë paguese individuale dhe rreziqe të tjera të klienteve).

Bordi i Shoqërisë ka deleguar përgjegjësinë për drejtimin e rrezikut të kredisë tek drejtimi, i cili është përgjegjës për mbikqyrjen e rrezikut të kredisë për Shoqërinë. Shoqëria monitoron përqendrimet e rrezikut të kredisë sipas llojit të pagesës (individuale dhe kompani të tjera).

Të gjitha llogaritë e arkëtueshme në 31 dhjetor 2013 kishin teprica për më pak se një vit.

Llogaritë e arketueshme të zhvleresuara

Llogaritë e arketueshme për të cilat Shoqëria percakton se nuk do të jete në gjendje të mbledhe të gjithë shumat e pashlyera sipas kushteve kontraktuale të marreveshjes(ve), janë të zhvleresuara.

Politika e cregjistrimit

Shoqëria cregjistron llogaritë e arkëtueshme (dhe cdo shume përkatëse të parashikuar për humbjet nga rënia në vlerë), në kohën kur drejtimi vendos se llogaritë e arkëtueshme janë të pambledhëshme. Ky përcaktim është arritur pasi janë marrë në konsideratë informacione si perpjekjet e rëndësishme që janë ndërmarrë për të arritur të mblidhen llogaritë e arkëtueshme, dhe nuk ka mundësi të tjera për mbledhjen e teprocave gjendje.

Kolaterali

Në përgjithësi nuk është mbajtur kolateral mbi të drejtat nga bankat dhe nuk ka kolateral të tillë më 31 dhjetor 2013. Depozitat e garancisë janë vendosur nga konsumatorët kur dorëzohen bombulat e gazit. (Shënimi 12).

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

17. Administratimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në plotësimin e angazhimeve nga detyrimet e saj financiare.

Drejtimi i rrezikut të likuiditetit

Pikëpamja e Shoqërisë për menaxhimin e likuiditetit është për të siguruar, aq sa është e mundur, që ai do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në kohën e duhur, në të dyja kushtet si ato të rënda dhe normale, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose rrezikun e dëmtimit të reputacionit të Shoqërisë. Tabela e mëposhtme tregon flukset monetare të skontuara mbi aktivet dhe detyrimet financiare mbi bazën e maturitetit kontraktual ose flukseve të prishme më të hershme.

31 dhjetor 2013	Deri në 6 muaj	6 deri 12 në muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	27,189	-	-	-	27,189
Aktivtë tregtare e të tjera	46,111	-	-	-	46,111
Aktivtë totale	73,300	-	-	-	73,300
Detyrimet					
Detyrime tregtare e të tjera	30,933	2,344	130,267	-	163,544
Detyrimet totale	30,933	2,344	130,267	-	163,544
Pozicioni likuiditeti neto	42,367	(2,344)	(130,267)		(90,244)
Pozicioni neto kumulativ	42,367	40,023	(90,244)		

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të cmimeve të tregut, sic janë kurset e këmbimit, normat e interesit dhe cmimet e kapitalit që do të ndikojnë të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumenteve financiare që mban ai. Objektivi i manaxhimit të rrezikut të tregut është për të manaxhuar dhe kontrolluar ekspozimet e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Kjo është një formë e rrezikut që rrjedh nga ndryshimi i cmimit të një monedhe kundrejt një tjetre. Rreziku i monedhës është manaxhuar duke monitoruar pozicionet e hapura valutore. Rreziku i monedhës drejtohet duke përdorur parimet e përputhjes aktive/detyrime. Shoqëria nuk ka pasur ndonjë transaksion si kontratë këmbimi 'forward' apo produkte derivative të integruara në kontrata më 31 dhjetor 2013.

Ekspozimi i Shoqërisë nga rreziku i monedhës së huaj në 31 dhjetor 2013 aktivet financiare dhe detyrimet financiare janë si më poshtë:

31 dhjetor 2013	Vlera në Lek '000	
	Euro	Totali
Aktivtë		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	7,364	7,364
Aktivtë tregtare e të tjera	24,745	24,745
Totali i aktiveve financiare	32,109	32,109
Detyrimet		
Detyrime tregtare e të tjera	143,256	143,256
Totali i detyrimeve financiare	143,256	143,256
Pozicioni likuiditeti neto	(111,147)	(111,147)
Pozicioni neto kumulativ	(111,147)	(111,147)

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

17. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut te normes se interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku i humbjes nga luhatjet në flukset e mjeteve monetare apo nga vlera e drejtë e instrumentave financiar për shkak të ndryshimit në normat e interesit të tregut. Shoqëria nuk është e ekspozuar nga vlerat e interesit sepse nuk ka mbajtur instrumenta financiar.

(e) Rreziqet operacionale

Rreziku operacional është rreziku i humbjes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që rrjedhin nga një shumëllojshmëri e gjerë të shkaqeve që lidhen me procese të Shoqërisë, personelit, teknologjisë dhe infrastrukturës, si dhe nga faktorë të jashtëm përveç risqeve të kredisë, tregut dhe likuiditetit, të tilla si ato që rrjedhin nga kërkesat ligjore dhe në përgjithësi standardet e pranuar të sjelljes së korporatës duke përfshirë reputacionin dhe rrezikun strategjik. Objektivi i Shoqërisë është që të manaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit të cilat e kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Pergjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i është caktuar Bordit. Kjo pergjegjësi është mbështetur nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Shoqërisë për manaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e pershtatshme të detyrave, duke përfshirë autorizimin e pavarur e transaksioneve
- kërkesat për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve të përshtatura me kërkesat ligjore
- pajtueshmëri me kërkesat ligjore
- dokumentimin e kontrolleve dhe procedurave
- kërkesat për vlerësimin periodik të risqeve operacionale të hasura, dhe përshtatshmerinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuar
- kërkesat për raportimin e humbjeve operacionale dhe të veprimit të propozuar përmiresuese
- zhvillimi i një plan emergjence
- standardet etike dhe të biznesit
- zbutjen e rrezikut, duke përfshirë sigurimin, kur ky është efektiv.

18. Kushtëzime dhe angazhime

Ligjore

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria haset me pretendimet ligjore dhe gjyqësore; drejtimi i Shoqërisë është i mendimit se asnjë humbje materiale nuk do të shkaktohet në lidhje me kërkesat ligjore, dhe se nuk ka pretendime ligjore të pazgjydhura më 31 dhjetor 2013.

Detyrimet e mundshme

Në mënyrë që të marrin parasysh çdo rrezik të mundshëm të humbjeve të lidhura me ndonjë inspektim të ardhshëm tatimor dhe vlerësimin e detyrimeve tatimore nga organet tatimore, Shoqëria vlerëson detyrimet e mundshme tatimore dhe probabilitetin që detyrimet e tilla të lindin.

Menaxhimi beson se nuk është aq e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e detyrimeve të mundshme në lidhje me tatimin mbi. Prandaj asnjë provigjon shtese per rreziqe tatimore nuk është njohur në këto pasqyra financiare.

Informacione të reja mund të jenë në dispozicion që të shkaktojnë ndryshimin e vendimeve në lidhje me përshtatshmerinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; ndryshimet e tilla ndikojnë shpenzimet e tatimit në periudhën që bëhen.

Angazhimet e qirasë

Shoqëria ka hyrë në angazhime të qirasë gjatë vitit 2013. Angazhimet totale me 31 dhjetor 2013, të pagueshme brenda një viti janë 1,110 mijë lekë.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprake SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

19. Related parties

Shoqëria mëmë është Messer Cutting System GmbH. Shoqëria hyn në veprime me Mëmën, me kompanitë e lidhura, dhe me Drejtuesit ekzekutive.

Balancat dhe veprimet me palët e lidhura

	2013
<i>Të arkëtueshme nga palët e lidhura:</i>	
Messer GTM, Kosovo	20,562
Messer Tehnogas Vardar	3,675
Messer Cutting System GmbH.	253
	24,490
<i>Në lidhje me palët e lidhura:</i>	
Messer Tehnogas	109,618
Messer Tehnogas Vardar	20,459
Messer Group	190
Bonus i përlllogaritur i menaxhimit	2,344
	132,611
	2013
Shitje	
Messer GTM, Kosovo	10,296
Messer Tehnogas Vardar	1,592
	11,888
Shpenzime	
Kompesimet e manaxhimit	10,257
Kosto shitje	95,400
	105,657

20. Ngjarje të mëvonshme

Nuk ka ngjarje të rëndësishme mbas datës së raportimit që kërkojnë rregullim apo shpalosje në pasqyrat financiare.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

21. Shpjegimi i kalimit në raportim sipas SNRF

Ashtu si u konstatua në shënimin 2 (a), si pjesë e konvertimit të saj sipas SNRF, Shoqëria ka përgatitur pasqyra SNRF paraprahe më 31 dhjetor 2013 për të caktuar pozicionin financiar, rezultatet e operacioneve dhe flukseve monetare për Shoqërinë, të nevojshme për të dhene informacionin krahasues qe pritet të përfshihet në pasqyrat e para të plota të Shoqërisë në përputhje me SNRF më 31 dhjetor 2014. Pasqyrat financiare paraprahe nuk e përfshijnë informacionin e plotë krahasues për periudhën.

Politikat kontabël të përcaktuara në shënimin 3 janë aplikuar për të përgatitur pasqyrat financiare për fundin e vitit 31 dhjetor 2013 dhe në përgatitjen e hapjes e pasqyrave SNRF të pozicionit financiar më 1 janar 2013 (data e tranzicionit të Shoqërisë)

Në përgatitjen e pozicionit financiar të hapjes së pasqyrave SNRF, Shoqëria ka rregulluara shumat e raportuara më parë sipas pasqyrave financiare në përputhje me bazen e vjetër të kontabilitetit (GAAP i mëparshëm)

Barazimi i bilancit të gjendjes

Shenime		1 janar 2013			31 dhjetor 2013		
		GAAP i mëparshëm	Rregullime	SNRF	GAAP i mëparshëm	Rregullime	SNRF
Aktive							
Aktive afatgjata materiale	a	436,550	21,962	458,512	437,334	21,802	459,136
Tax aktiveve të shtyra	b	-	501	501	-	-	-
Aktive afatgjatë		436,550	22,463	459,013	437,334	21,802	459,136
Inventari	e	42,460	(10,255)	32,205	20,394	-	20,394
Të arkëtueshme tregtare e të tjera	c	70,885	(26,656)	44,229	46,111	-	46,111
Tatim mbi të ardhurat e parapaguara		1,603	-	1,603	2,228	-	2,228
Parapagime dhe aktive të tjera	d	12,140	(11,029)	1,111	1,157	-	1,157
Mjete monetare dhe ekuivalente		23,810	-	23,810	27,189	-	27,189
Aktivët afatshkurtër		150,898	(47,940)	102,958	97,079	-	97,079
Aktivët totale		587,448	(25,477)	561,971	534,413	21,802	556,215
Kapital							
Kapital i aksionuar	g	505,272	6,500	511,772	505,272	6,500	511,772
Rezerva		6,208	-	6,208	6,208	-	6,208
Humbje të mbartura	a-f	(59,618)	(14,910)	(74,528)	(166,075)	15,526	(150,549)
Kapitali total		451,862	(8,410)	443,452	345,405	22,026	367,431
Detyrime							
Detyrimet e shtyra tatimore	b	-	-	-	-	3,270	3,270
Detyrimet afatgjatë		-	-	-	-	3,270	3,270
Detyrime tregtare dhe të tjera	f,g	122,232	(17,067)	105,165	167,038	(3,494)	163,544
Të ardhura të shtyra		13,354	-	13,354	21,970	-	21,970
Detyrimet afatshkurtër		135,586	(17,067)	118,519	189,008	(3,494)	185,514
Detyrimet totale		135,586	(17,067)	118,519	189,008	(224)	188,784
Total detyrime dhe kapital		587,448	(25,477)	561,971	534,413	21,802	556,215

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprahe SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

21. Shpjegimi i kalimit në raportim sipas SNRF (vazhdim)

Ndryshimet midis pasqyrave të pozicionit financiar të përgatitura sipas SNRF dhe sipas GAAP-it të mëparshëm më 1 janar 2013 dhe në 31 dhjetor 2013 përfshirë sa më poshtë:

Shënime	Përshkrim	Efekti në pozicionin financiar dhe të ardhurave /shpenzime ('ASH')	Më 1 janar 2013	Më 31 dhjetor 2013	Fitimet ose (humbjet) në 2013
a	Normat e ndryshme të amortizimit bazuar në jetën e përdorimit për SNRF	Rritje: Aktive afatgjata materiale Zbritje: Humbjet e mbartura Zbritje: Kostot e shitjeve (ASH)	21,962	21,802	155
b	Taksa e shtyrë nuk kërkohet sipas GAAP	Rritje: Taksa e shtyrë aktive/(detyrime) Zbritje/(Rritje): Humbje të mbartura Rritje: Shpenzim tatimi (ASH)	501	(3,270)	(3,771)
c	Rënia në vlerë e llogarive të arkëtueshme deri më 1 janar 2013 për SNRF dhe njohur gjatë 2013 për GAAP	Zbritje: Të arkëtueshmet tregtare Rritje:Humbje të mbartura Zbritje: Shpenzime shitje dhe shpërndarje (ASH)	(26,656)	-	26,656
d	Aktivet e vjetra të fshira njohur më 1 janar 2013 për SNRF dhe gjatë 2013 për GAAP	Zbritje: Parapagime dhe aktive të tjera Rritje: Humbje të mbartura Zbritje: Shpenzime shitje dhe shpërndarje (ASH)	(11,029)	-	11,029
e	Aktivet e vjetra të fshira njohur më 1 janar 2013 për SNRF dhe gjatë 2013 për GAAP	Zbritje: Inventari Rritje: Humbje të mbartura Zbritje: Kostot e shitjeve (ASH)	(10,255)	-	10,255
f	Shpenzimet e njohura në periudhën kur kryhen për SNRF dhe kur paguhen / rregullohen për GAAP	Zbritje/(Rritje): Të pagueshme tregtare e te tjera Zbritje: Humbje të mbartura Rritje: Kostot e shitjeve (ASH)	10,567	(3,006)	(13,888)
g	Riklasifikimi i kontributeve nga pronari nga detyrimet tek kapitali	Zbritje: Të tjera të pagueshme Rritje: Kapital themeltar	6,500	6,500	-

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare paraprake SNRF

(Shumat në Lek '000, nëse nuk shprehet ndryshe)

21. Shpjegimi i kalimit në raportim sipas SNRF (vazhdim)

Barazimi i pasqyrës së humbjes dhe fitimit dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

	Shënime (si më lart)	GAAP i mëparshëm	Rregullime	SNRF
Shitje		268,268	-	268,268
Kosto e shitjeve	a,e,f	(244,668)	(3,478)	(248,146)
Fitimi bruto		23,600	(3,478)	20,122
Të ardhura të tjera		1,273	-	1,273
Shpenzime shitje dhe shpërndarje	c,d	(112,201)	37,685	(74,516)
Shpenzime administrative		(17,836)	-	(17,836)
Rezultatet nga aktivitet operative		(105,164)	34,207	(70,957)
Kostot financiare		(516)	-	(516)
Humbje para tatimit		(105,680)	34,207	(71,473)
Shpenzim tatimi	b	(777)	(3,771)	(4,548)
Humbja e vitit		(106,457)	30,436	(76,021)
Humbje të tjera përmbledhëse për vitin, neto nga tatimi				
Humbje totale përmbledhëse e vitit		(106,457)	30,436	(76,021)

Rregullimet në pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

Nuk ka dallime të mëdha mes pasqyrave të flukseve të mjeteve monetare të paraqitura sipas SNRF dhe sipas GAAP-it të mëparshëm.